



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 3.12.2019

(Dokument parlamentar)

(Komisioni përgjegjës)

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE NR.6, DATË 30.11.2019 “PËR DHURIMIN E APARTAMENTEVE
FAMILJARËVE TË VIKTIMAVE, SI PASOJË E TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019”**

• ***Hyrje.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjen e datës 3 dhjetor 2019, shqyrtoi projektligjin “Për miratimin e aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr.6, datë 30.11.2019 “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019”. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit përgjegjës.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur aktin normativ dhe për të dhënë informacionet e kërkuara nga deputetët, Ministrja e Financave dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie. Komisioni caktoi relator, për shqyrtimin e këtij akti normativ, z. Arben Ahmetaj.

• ***Baza ligjore.***

Akti normativ është propozuar nga Këshilli i Ministrave, bazuar në nenin 101 të kushtetutës. Ai është në përputhje me kërkesat e ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” dhe të ligjit

nr.22/2018 “Për strehimin social”. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton aktin normativ në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi, nevoja dhe rëndësia e aktit normativ.***

Akti normativ u bë i nevojshëm për shkak të fatkeqësisë natyrore që ndodhi në vendin tonë, tërmetit të datës 26 nëntor 2019, i cili shkaktoi viktima dhe shëmbje apo dëmtime banesash në disa zona të vendit. Ai është hartuar në kuadër të masave që po ndërmerr Qeveria për t’u ardhur në ndihmë familjarëve të viktimave të tërmetit. Qëllimi i tij është minimizimi i pasojave të tërmetit, duke u siguruar familjarëve të viktimave strehim sa më të shpejtë, nëpërmjet dhurimit të banesave nga njësitë e vetqeverisjes vendore. Duke qenë se strehimi i këtyre familjeve përbën një çështje mjaft të rëndësishme dhe emergjente, rregullimet ligjore për këtë çështje u propozuan nga Këshilli i Ministrave me akt normativ.

Akti normativ parashikon këto rregullime ligjore:

Së pari, Bashkia Tiranë, specifikisht njësia administrative nr.1, dhuron 17 apartamente në pronësi të saj, për familjarët e viktimave të tërmetit;

Së dyti, të gjitha njësitë e vetqeverisjes vendore kanë të drejtë të dhurojnë apartamente në favor të familjarëve të viktimave të tërmetit, të cilat janë pjesë e fondit publik të banesave sociale;

Së treti, në përputhje me ligjin për vetqeverisjen vendore, tjetërsimi i banesave bëhet pas dhënies së pëlqimit nga këshilli bashkiak i njësisë së vetqeverisjes vendore.

Së katërti, shpenzimet procedurale për kryerjen e transaksioneve të dhurimit të pasurisë paguhet nga njësia përkatëse e vetqeverisjes vendore;

Së pesti, buxheti i shtetit financon të gjitha shpenzimet e mobilimit dhe të furnizimit me pajisje elektroshtëpiake të këtyre banesave.

Gjithashtu, akti normativ parashikon procedurat për kryerjen e tjetërsimit të banesave, si dhe mbështetjen që do të sigurohet nga strukturat shtetërore me burimet njerëzore dhe mjetet logjistike të nevojshme për realizimin e procesit të transferimit të banesave.

- **Diskutimi në Komision.**

Relatori paraqiti rregulimet ligjore që parashikohen në aktin normativ, si dhe nevojën, rëndësinë dhe emergjencën e tyre.

Ministrja e Financave prezantoi aktin normativ dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve.

Gjatë diskutimit anëtarët e Komisionit shprehën mendimin se miratimi i aktit normativ nga Kuvendi është me rëndësi të veçantë dhe emergjent, për t'u krijuar kushte banimi familjarëve të viktimave të tërmetit dhe për t'u lehtësuar jetesën në këto ditë të vështira. Transferimi i pasurive të paluajtshme nga njësitë e pushtetit vendor, tek familjet e viktimave të tërmetit është në përputhje me kuadrin ligjor për vetqeverisjen vendore dhe strehimin social. Në nenin 9 të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” përcaktohet se:

“Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë:

- a) njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;*
- b) e drejta e fitimit të pronës, nëpërmjet shpronësimeve për interes publik, nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;*
- c) e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër.”*

- **Përfundim.**

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

KRYETARI

Arben AHMETAJ